



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.11/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija – JGP, me seli në Dragash, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndaj Vendimit të KQZ-së Nr. 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për miratimin e formulës së përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve për vendvotimet e rregullta, me kusht dhe rezervë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me 28.12.2025., në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.12.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP), me seli në Dragash, ZP.Anr.11/2025 e datës 10.12.2025, e paraqitur ndaj Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta, me kusht dhe rezervë, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Komisionet e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 10.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Jedinstvena Goranska Partija – JGP, me seli në Dragash, në të cilën theksojnë se gjatë procesit të fundit të shpërndarjes së anëtarëve të komisioneve zgjedhore, ka ndodhur devijim nga disa norma relevante, anëtarët e komisioneve zgjedhore të ndarë partive të bashkësive jo shumicë janë zvogëluar në një masë që devijon nga parimi kushtetues i përfaqësimit adekuat dhe të garantuar.

Sipas parashtruesit të ankesës kjo praktikë është në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që garantojnë pjesëmarrje efektive të bashkësive jo shumicë në institucionet publike.

Tutje në ankesë theksohet se KQZ-ja ka aplikuar kritere që nuk bëjnë dallim midis subjekteve parlamentare dhe jo parlamentarë, megjithëse Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme parashikon trajtim të diferencuar në përputhje me statusin e tyre ligjor, kapacitetin zgjedhor dhe rezultatin në zgjedhjet e mëparshme. Është vërtetuar një devijim i rëndësishëm në favor të subjekteve të

caktuara, duke përfshirë edhe ato që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit lokale, në zgjedhjet e mëparshme parlamentare kanë një numër marginal votash, dhe në këtë proces marrin një numër më të madh anëtarësh të komisioneve zgjedhore sesa është legjitimiteti i tyre i shprehur nëpërmjet votave të zgjedhësve.

Po ashtu në ankese theksohet se një veprim i tillë i KQZ-së përfaqëson shkelje të parimit të proporcionalitetit, të përfaqësimit në bazë të forcës reale zgjedhore, si dhe të parimit të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të pushtetit publik., si dhe sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, bashkësia gorane është më e shumta ndër bashkësitë jo shumicë, gjë që i imponon KQZ-së një detyrim pozitiv për të siguruar përfaqësim institucional proporcional, duke përfshirë edhe pjesëmarrje adekuate në komisionet zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës thekson se në kundërshtim me këtë parim, numri i anëtarëve të komisioneve zgjedhore të ndarë partive që përfaqësojnë bashkësinë gorane vazhdimisht po zvogëlohet nga viti në vit, gjë që përfaqëson një model veprimi që është në kundërshtim me parimin kushtetues të mbrojtjes së bashkësive jo shumicë, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave (Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës, kriteret e Kopenhagës).

Prandaj parashtruesi i ankesës kërkon anulimin e vendimit të KQZ-së për shpërndarjen e anëtarëve të komisioneve zgjedhore për komunën e Dragashit dhe urdhërimin e një shpërndarjeje të re në përputhje me parimet e proporcionalitetit, të mbrojtjes kushtetuese të bashkësive jo shumicë dhe formulës në fuqi për përcaktimin e përbërjes së komisioneve zgjedhore, përputhjen e shpërndarjes me të dhënat demografike dhe rezultatet zgjedhore, duke siguruar që bashkësitë me numrin më të madh të banorëve ndër bashkësitë jo shumicë të marrin një numër adekuat dhe proporcional anëtarësh, urdhërimin e KQZ-së që në shpërndarjet e ardhshme t'i përmbahet rreptësisht dispozitave ligjore dhe kushtetuese, duke përfshirë detyrimin e trajtimit të drejtë të të gjithë subjekteve politike.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, thekson se duke u bazuar në Ligjin Nr., 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.- 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve, ka emëruar "Përbërjen e Këshillit të Vendvotimit (KVV)". Ky vendim është marrë duke u mbështetur plotësisht në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore Nr. 11/2024, të cilat rregullojnë mënyrën e nominimit, përzgjedhjes dhe caktimit të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, si përfaqësimi në KVV 1.1.1. Subjektet politike të certifikuara, të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, kanë të drejtë të nominojnë nga një (1) anëtar në KVV. Po ashtu, përfaqësim edhe subjekteve politike të reja të certifikuara për zgjedhje. 1.1.2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV, 1.1.3. KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), 2.Përfaqësimi i komuniteteve në KVV 2.1.1 Numrin e dallueshëm të popullsisë brenda komunave, 2.1.2 Numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal, 3.KQZ ka vazhduar duke marr për bazë edhe kriteret tjera shtesë: 3.1.1 KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara

në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara 3.1.2 Nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme (28 Dhjetor) 3.1.3 KKZ ka të drejtë t'i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet. Në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, komuniteti Goran siguron përfaqësimin e tij institucional përmes subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP) dhe kandidatit të pavarur Nedžmidin Sejdilar. Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve, këtyre subjekteve u janë alokuar në mënyrë të ligjshme gjithsej 51 pozita në Këshillat e Vendvotimeve (KVV).

Jedinstvena Goranska Partija (JGP) është e përfaqësuar në komunat Dragash dhe Prizren, me këtë përbërje të miratuar nga KQZ: 3 kryesues, 34 anëtarë të rregullt, 2 anëtarë rezervë. Ndërkaq, kandidati i pavarur Nedžmidin Sejdilar është i përfaqësuar në Komunën e Dragashit, me gjithsej 12 anëtarë në Këshillat e Vendvotimeve. Ky nivel i përfaqësimit është bërë duke respektuar parimet ligjore të proporcionalitetit, transparencës dhe barazisë në përbërjen e KVV-ve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Vendimi i KQZ-së, me nr. Protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin Rekomandimit të Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, lidhur me shpërndarjen e Komisionarëve të vendvotimeve që u caktohen partive të komuniteteve janë të pa bazuara.

Me nenin 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, ku parashihet që *”Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ. Me dispozitën e nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që: “Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që: “Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni”.*

Me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit parasheh që: *“KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse”.* Paragrafi 2 i Rregullores parasheh që: *“Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale”.*

Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore parasheh që: *“Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve”*. Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve parashihet që: *“KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal”*.

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës se, me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, kjo për faktin se me rastin e përcaktimit të numrit të ekipeve të numërimit ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi krejt duke marrë parasysh rezultatet zgjedhore të fundit dhe renditjes së subjekteve politike, përfshirë edhe subjektin politik ankues. Kjo pasi që subjektin politik Jedinstvena Goranska Partija, dhe kandidatit të pavarur Nedzmidin Sejdillar, u janë alokuar në mënyrë të ligjshme 51 pozita në Këshillat e Vendvotimeve, që do të thotë se subjekti politik Jedinstvena Goranska Partija në Komunën e Dragashit dhe Prizrenit i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ-së, me këtë përbërje 3 kryesues 34 anëtare të rregullt dhe 2 anëtare rezerve, Po ashtu, edhe kandidatit të pavarur Nedzmidin Sejdillar është i përfaqësuar në Komunën e Dragashit me gjithsej 12 anëtare në KVV.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtresë i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Janë vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të parashtresit të ankuesit, por paneli nuk ka gjetur se nga vendimet e atakuara janë përfshirë me ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtuara më lart bazuar në nenin 117.3 dhe 119.3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.11/2025, datë 13.12.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-s në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.